




Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



Rregullën NR.02/2015

RREGULLAT DHE PROCEDURAT

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (më tutje në tekst: “PZAP”), do të thotë një organ i pavarur përgjegjës për vendosjen për parashtresat dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor.

Në pajtim me autorizimin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në Ligjin Nr. 03/L-256, dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-072), ku të gjitha janë të përfshira në këto rregulla dhe procedura dhe janë pjesë e saj, ashtu siç është paraqitur në mënyrë të plotë,

Nxjerrë në vijim Rregullat dhe Procedurat (më tutje në tekst: “rregullat”):

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1.1 Me këtë rregull përcaktohet zhvillimi i procedurave lidhur me ankesat e parashtruara nga subjektet politike, kandidatët dhe të gjithë personave të drejtat e të cilëve supozohet se i janë shkelur gjatë procesit zgjedhor dhe apelet ndaj vendimeve të parapara sipas ligjit dhe rregullave zgjedhore.

Neni 2

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë këtë kuptim:

2.1 “Ankesë” – do të thotë mjet i rregullt juridik i dorëzuar me shkrim nga një person që ka interes ligjor apo të drejtat e të cilit janë shkelur gjatë procesit zgjedhor.

2.2 “Apel” – do të thotë mjet i rregullt juridik kundër vendimeve të shkallës së parë.

2.3 “Afat” – do të thotë koha brenda të cilit duhet të kryhet apo mund të kryhet veprimi procedural i caktuar.

2.4 “Gjobë” – do të thotë shuma e të hollave të shqiptuara me vendim për shkelje të dispozitave ligjore, të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, dhe Ligjit Nr.03/L-072, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

2.5 “PZAP” – do të thotë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, organ i pavarur përgjegjës për vendosjen për parashtresa dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor.

2.6 “KQZ” – do të thotë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, organ i pavarur për administrimin e zgjedhjeve.

2.7 “Parashtresë” – janë ankesat, apelet si dhe të gjitha shkresat tjera të dorëzuara me shkrim në PZAP.

2.8 “Procedurë” - do të thotë rregulla mbi organizimin me të cilat përcaktohen veprimet e pjesëmarrësve në procesin pranë PZAP-it.

2.9 “Seancë” – Takim i anëtarëve të panelit për të vendosur për një çështje të caktuar që lidhet me procesin zgjedhor.

2.10 “Sanksion” – do të thotë masë ndëshkuese për shkelje të dispozitave ligjore dhe rregullave për kategorizimin e sanksioneve dhe gjobave lidhur me procesin zgjedhor.

Neni 3 **Fushëveprimi**

3.1 Të gjitha subjektet politike, dhe personat të cilët kanë interes ligjor, supozohet se janë të njoftuar me ligjet në fuqi për procesin zgjedhor, si dhe me të gjitha rregullat dhe procedurat zgjedhore.

3.2 PZAP-i përbëhet nga dhjetë (10) anëtarë, përfshirë kryesuesin i cili vjen nga radha e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe anëtarët e tjerë që vijnë nga radha e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit dhe nga radha e gjyqtarëve të Gjykatave Themelore të Kosovës. PZAP-i mund të mblidhet në seanca të ndara me nga së paku tre (3) anëtarë. Kryesuesi i PZAP-it me vendim emëron kryesuesin e seancës dhe anëtarët e panelit vendim-marrës. Për çështje të rëndësisë së veçantë Kryesuesi i PZAP-it mund të krijojë një panel që do të përbëhet nga nëntë (9) anëtarët e PZAP-it.

3.3 Anëtarët e PZAP-it duhet ti kryejnë detyrat e tyre duke u mbështetur në parimet: e efikasitetit, objektivitetit, paanshmërisë, si dhe të i përmbahen konfidencialitetit në raport me informatat e pranuar.

3.4 Kryesuesi i çdo paneli vendim-marrës do t'i caktojë seancat sipas nevojës dhe do t'i japë detyra Sekretariatit të PZAP-it në bazë të nenit 123.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256). Paneli i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se e konsideron këtë të nevojshëm.

3.5 Panelet vendim-marrëse i marrin vendimet me shumicë votash. Në rrethana emergjente, Kryesuesi i PZAP-it apo i deleguari i tij/saj dhe një anëtar i panelit vendim-marrës (përkatës), mund të marrin vendime për PZAP-in, pas konsultimit me anëtarët e tjerë nëse për këtë ekziston mundësia. Në rrethana të tilla, ky vendim konsiderohet si vendim i PZAP-it.

3.6 Gjuhët e punës së PZAP-it do të jenë në pajtim me Ligjin Nr. 02/L-37 Për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës.

3.7 PZAP- i mund të kërkoj nga palët e treta, dhe të cilat janë të obliguara që ti ofrojnë informata, dokumente, deklaratata, aktgjykime, aktvendime apo çfarë do materiali tjetër zyrtar për nevoja të vendosjes së çështjeve (rasteve) të caktuara.

3.8 PZAP-i mund ta trajtoj ankesën e dorëzuar si një apelim, në rastet kur konsideron se ankesa e dorëzuar do të trajtohej në mënyrë më të duhur si apelim dhe anasjelltas.

3.9 Në bazë të nenit 116.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256), PZAP-i mund të kërkojë çfarëdo lloj ndihme dhe informacioni nga institucionet e Republikës së Kosovës, çdo herë që konsideron se kjo është e nevojshme.

3.10 Dhënia e Informatave, dëshmime apo deklaratave të rrejshme PZAP-it nga një person, organizatë apo organ menaxhues i zgjedhjeve, do të hetohen ex officio nga PZAP-i dhe mund të sanksionohen nga PZAP-i, në bazë të neneve 29.9 dhe 119.6 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256).

3.11 Rastet e përgjegjësive individuale gjatë procesit zgjedhor që janë të ndëshkueshme me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, do të përcillen nga PZAP-i në zyrën e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës.

3.12 Të gjitha ankesat që kanë të bëjnë me parregullsitë dhe shkeljet e bëra nga ana e mediave gjatë fushatës së zgjedhjeve PZAP-i do t'i përcjellë për vendosje tek Komisioni i Pavarur për Media (KPM) në bazë të nenit 51.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256) LZP.

3.13 Ndryshimi i këtyre rregullave dhe procedurave bëhet me shumicë të të gjithë anëtarëve të PZAP-it.

SEKRETARIATI I PZAP-it

Neni 4

4.1 PZAP-i ndihmohet në ushtrimin e përgjegjësive dhe funksioneve të tij nga Sekretariati, në pajtim me nenin 123 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256).

ANKESAT

Neni 5

Kushtet për dorëzimin e ankesave

5.1 Ankesat mund të dorëzohen në selin e PZAP-it në Prishtinë drejtëdrejt apo përmes postes.

5.2 PZAP-i do të konsiderojë se ankesa është parashtruar në datën e pranimit të ankesës në vendin e lartpërmendur, apo nëse është dërguar me postë, në datën kur është vulosur nga posta.

5.3 Ankesat në lidhje me procesin zgjedhor për ditën e votimit parashtrohen pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga moment i mbylljes së qendrës së votimit, (Neni 119.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256).

5.4 Ankesat në lidhje me administrimin e numërimit në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve duhet të dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i të kuptuarit nga ankuesi/ja për shkeljen e supozuar, në bazë të nenit 105.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256).

5.5 Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar.

5.6 Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari. Në rastet kur ankuesi/ja është parti politike, koalicion, iniciativë qytetare ose çfarëdo personi tjetër juridik, ankesa duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i atij personi juridik siç është përcaktuar, në rastet ku kjo është e mundshme, në çfarëdo dispozite ligjore në fuqi.

5.7 Palët ankuese duhet të përdorin formularin e gatshëm për ankesat e tyre, kurdo që kjo është e mundshme. Formularët e ankesave mund të merren në selinë e PZAP-it ose të printohen nga ueb-faqja e PZAP-it. Po ashtu, gjatë ditës së zgjedhjeve formulari i ankesave do të jetë i gatshëm në të gjitha vendvotimet përkatëse. Të gjitha ankesat duhet të kenë së paku informacionet vijuese:

- a. emrin, adresën dhe informacionet për kontaktim të ankuesit.
- b. një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.
- c. hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit. dhe
- d. vërtetimin nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës.

Në rastet kur kjo është e mundshme, në ankesë gjithashtu duhet të ceket:

- e. emri, adresa dhe informacionet për kontaktim (nëse janë në dispozicion) të shkelësit të pretenduar.
- f. emrat, adresat dhe informacionet për kontaktim (nëse janë në dispozicion) të cilitdo dëshmitar.

5.8 Raportet në bazë të neneve 80.3 dhe 85.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256) do të konsiderohen si ankesa dhe do të merren parasysh si të tilla nga PZAP-i.

5.9 PZAP-i i pranon të gjitha ankesat e dorëzuara në pajtim me Ligjin Nr. 02/L-37 Për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës.

Neni 6

Shqyrtimi i ankesave

- 6.1 Çdo ankesë e pranuar në PZAP do të regjistrohet me numër të protokollit dhe do të jetë pjesë e lëndës dhe e regjistrit të përhershëm të PZAP-it.
- 6.2 Deri në marrjen e vendimit kryesore, për shqyrtimin e ankesës palët mund ta terheqin ankesën e parashtruar.
- 6.3 Ankesa e cila nuk i plotëson kriteret e parapara sipas nenit 5.7 të ktyre rregullave, i kthehet pales ankuese në përmisim dhe plotësim në afat prej njëzetekatër (24) orëve. Do të konsiderohet si e tërhequr ankesa poqëse nuk i kthehet PZAP-it brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet e pa korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, ankesa do të hidhet poshtë.
- 6.4 Ankesat të cilat janë të palejuara dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim.
- 6.5 PZAP-i, me vendim aprovon-refuzon ankesat në përputhje me dispozitat ligjore.
- 6.6 Në rastet kur PZAP-i konsideron se ankesa është e rregullt, pala ndaj së cilës është parashtruar ankesa do të njoftohet dhe do t'i sugjerohet se ka të drejtë të përgjigjet në ankesë në afat prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti i pranimit të ankesës së bashku me provat.
- 6.7 Pala e cila është njoftuar nga PZAP-i se është bërë ankesë ndaj saj, e njëjta mund të ndërmarr masa përmirësuese brenda afatit të caktuar nga PZAP-i prej njëzetekatër (24) orëve nga pranimi i urdhrit për përmirësim.

Neni 7

Dorëzimi i përgjigjes ndaj ankesës

- 7.1 Pala ndaj së cilës është parashtruar ankesa, mund të parashtroj përgjigje në ankesë PZAP-it. Përgjigja në ankesë duhet të dorëzohet në PZAP, brenda kohës së cekur në njoftim.
- 7.2 Përgjigja ndaj ankesës duhet të dorëzohet me shkrim dhe të nënshkruhet nga pala ndaj së cilës është parashtruar ankesa apo nga i autorizuari i saj. Në rastet kur pala ndaj së cilës është parashtruar ankesa është parti politike, koalicion, iniciativë qytetare, përgjigjen në ankesë duhet ta nënshkruajë përfaqësuesi i autorizuar i saj.
- 7.3 Përgjigja duhet të ketë informatat vijuese:
- a. emrin, adresën dhe informatat për kontaktim të palës ndaj së cilës është parashtruar ankesa.
 - b. mbrojtjen kundër shkeljes së pretenduar, pranimin se pala ndaj së cilës është parashtruar ankesa e ka kryer shkeljen apo deklaratën se edhe nëse aktiviteti i përshkruar në ankesë ka ndodhur, ai aktivitetet nuk paraqet shkelje. dhe

- c. vërtetimin nga pala ndaj së cilës është parashtruar ankesa lidhur me vërtetësinë e përgjigjes.

Në rastet kur kjo është e mundshme, në përgjigje duhet të paraqiten:

- d. Dëshminë lidhur me ndërmarrjen e masës përmirësuese për evitimin e shkeljes së pretenduar në ankesë.
- e. hollësitë rreth çfarëdo dëshmie dhe kopjet e cilitdo dokumentacion apo dëshmie relevante.
- f. emrin, adresën dhe informacionet për kontaktim të cilitdo dëshmitar; dhe
- g. çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

7.4 Përgjigja në ankesë mund të dorëzohet në selinë e PZAP-it në Prishtinë drejtpërdrejt apo përmes postës.

7.5 Mos dorëzimi i përgjigjes në ankesë si dhe mosdorëzimi i sajë me kohë, nuk është pengesë që PZAP-i të vendos lidhur me ankesën.

Neni 8

Vendimet për ankesat

8.1 Për ankesat në lidhje me administrimin e numërimit në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve, vendoset jo më vonë se shtatëdhjetëdy (72) orë nga momenti i pranimit të ankesës në selinë qendrore të PZAP-it, në bazë të nenit 105.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256).

8.2 Përveç nëse është saktësuar diku ndonjë afat tjetër, për ankesën do të vendoset sa më parë që është e mundur, pasi të jenë krijuar bazat faktike për marrjen e vendimit.

8.3 Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, kryesuesi i panelit vendim marres mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim.

8.4 Panelet vendim-marrëse mund ta refuzojnë ankesën apo disa ankesa, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe me rregullat zgjedhore në fuqi apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.

8.5 Paneli vendim-marrës, vetëm kur e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme të fillojë hetimin lidhur me çështjet e ankesës, por nuk është i obliguar ta bëjë këtë.

8.6 Sipas detyres zyrtar paneli mund të mbajnë seanca dëgjimore, të cilat do të mbahen në atë mënyrë që paneli e konsideron si të duhur. Paneli mund të mbajë seanca të mbyllura dëgjimore apo të mos përfshijnë në atë seancë ose në cilëndo pjesë të saj çdo person a grup personash, në rastet kur paneli mendon se për arsye të rendit publik ose të sigurisë së cilësdos prej palëve të përfshira mund të kërkohet marrja e vendimit të tillë.

8.7 Gjatë mbajtjes së seancës dëgjimore, paneli vendim-marrës mund:

- a. të kërkojë nga çdo person që të vijë dhe t'i paraqesë dëshmitë që mund të ndihmojnë panelin në marrjen e vendimit.
- b. t'ua mundësojë dëshmitarëve të japin dëshmi nën betim apo në ndonjë mënyrë tjetër.
- c. të kërkojë dhe të pranojë dëshmi relevante, të cilat paneli i konsideron si të duhura.

8.8 Panelet vendim-marrëse mund të shqyrtojnë të gjitha dëshmitë relevante të dorëzuara me kohë. Bazuar në këto dëshmi dhe në dëshmitë e tjera, të cilat paneli mund t'i merr në konsideratë, panelet vendim-marrëse e pranojnë ankesën në rastet kur pretendimet janë mirë të bazuara. Panelet vendim-marrëse i refuzojnë ankesat që nuk e plotësojnë këtë standard. Përgjegjësia për dhënien e dëshmisë është në anën e palës ankuese. Panelet vendim-marrëse mund të shqyrtojnë sipas detyrës zyrtare dëshmi të tjera relevante, por nuk janë të obliguar ta bëjnë një gjë të tillë.

8.9 Me rastin e përcaktimit të sanksioneve apo të gjobave, panelet vendim-marrëse sigurohen që sanksioni të jetë në proporcion me shkeljen e bërë.

8.10 Vendimet e PZAP-it lidhur me ankesat duhet të përpilohen me shkrim të përmbajnë dispozitiv të qarte dhe arsyetim për gjendjen faktike të vërtetuar si dhe dispozitat përkatëse për aplikimin e të drejtës procedurale dhe materiale, të cilat vendime duhet të ju dërgohen palëve në afatet e përcaktuara në nenin 118.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256),

8.11 Vendimet e PZAP-it do të publikohen në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, Ligji Nr. 02/L-37. Të gjitha vendimet do të jenë në dispozicion të publikut përmes web faqes së PZAP-it.

Neni 9

Respektimi i vendimeve të Panelit

9.1 PZAP-i mund të veprojë sipas detyrës zyrtare në reagim të moszbatimit të veprimit korrigjues të urdhëruar nga PZAP-i nga ana e personit, organizatës apo organit menaxhues të zgjedhjeve të sanksionuar apo të mospagesës së gjobës së shqiptuar brenda periudhës së saktësuar në vendimin e PZAP-it, në bazë të nenit 120.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256)

9.2 Gjobat paguhën në përputhje me udhëzimet e dhëna nga PZAP-i.

APELET
Neni 10
Kriteret për apelim

- 10.1 Apelet mund të dorëzohen në selinë e PZAP-it në Prishtinë drejtëpërdrejt apo përmes postës
- 10.2 PZAP-i do t'i konsiderojë se apeli është parashtruar në datën e parnimit të apelit në vendin e lartpërmendur, apo nëse është dërguar me postë, në datën kur është vulosur nga posta.
- 10.3 Apelet lidhur me aplikimin për certifikim nga një subjekt politik, në bazë të nenit 16.5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256), mund të parashtrohen në PZAP brenda pesë (5) ditësh pas njoftimit të subjektit politik me vendimin e KQZ-së.
- 10.4 Apelet lidhur me certifikimin e listës së kandidatëve, në bazë të nenit 26.6 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256), mund të parashtrohen në PZAP brenda pesë (5) ditësh pas njoftimit të tij/saj me vendimin e KQZ-së.
- 10.5 Në lidhje me apelimin e një vendimi të KQZ-së, apeli duhet të dorëzohet brenda pesë (5) ditëve pas njoftimit me vendim të KQZ-së. Për të gjitha apelet tjera, përveç nëse është saktësuar diku ndonjë afat tjetër, apelet duhet të dorëzohen brenda njëzetekatër (24) orë nga pranimi i vendimit të PZAP-it nga parashtruesi/ja.
- 10.6 Apelet duhet të dorëzohen me shkrim dhe të jenë të nënshkruara nga parashtruesi i apelit apo në emër të tij nga personi i autorizuar. Në rastet kur parashtruesi i apelit ankuesi/ja është parti politike, koalicion, iniciativë qytetare ose çfarëdo personi tjetër juridik, apeli duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i atij personi juridik siç është përcaktuar, në rastet ku kjo është e mundshme, në çfarëdo dispozite ligjore në fuqi.
- 10.7 Personi që e dorëzon apelimin duhet të përdorë formularin e gatshëm për apeline, kurdo që kjo është e mundshme. Formularët për apeline mund të merren në Sekretariatën e PZAP-it, dhe në ueb faqen e tij. Të gjitha apelimet duhet të kenë së paku informacionet vijuese:
- a. emrin, adresën dhe informacionet për kontaktim të personit që e dorëzon apelimin.
 - b. arsyen për dorëzimin e apelimit.
 - c. hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të personit që e dorëzon apelimin apo udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të parashtruesi/ja të apelimit dhe
 - d. vërtetimin nga personi që e dorëzon apelimin lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së apelimit.

10.8 PZAP-i i pranon të gjitha apelet e dorëzuara në cilëndo gjuhë zyrtare sipas legjislacionit për përdorimin e gjuhëve (Ligji Nr. 02/L-37).

Neni 11

Shqyrtimi i apelimeve

11.1 Çdo apel i pranuar në PZAP do të regjistrohet me numër të protokollit dhe do të jetë pjesë lëndës dhe e regjistrit të përhershëm të PZAP-it.

11.2 Deri në marrjen e vendimit kryesor, për shqyrtimin e apelit, palët mund ta tërheqin apelin e parashtruar.

11.3 PZAP-i e ekzaminon vendimin e shkallës së parë të apeluar, në pjesën në të cilën është apeluar dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të parashtruara me apel.

11.4 Apeli i cili nuk i plotëson kriteret e parapara sipas nenit 10.7 të ktyre rregullave, i kthehet palës ankuese në përmisim dhe plotësim në afat prej njëzetekatër (24) orëve. Do të konsiderohet si i tërhequr apeli poqëse nuk i kthehet PZAP-it brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet i pa korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, apeli do të hidhet poshtë.

11.5 Apelet të cilat janë të palejuara dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim.

11.6 PZAP me vendim aprovon -refuzon apelet në përputhje me dispozitat ligjore

11.7 Në rastet kur PZAP-i konsideron se apeli është i rregullt, pala ndaj së cilës është parashtruar apeli do të njoftohet dhe do t'i sugjerohet se ka të drejtë të përgjigjet në apel në afat prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti i pranimit të apelit së bashku me provat.

Neni 12

Dorëzimi i përgjigjes në apel

12.1 Pala ndaj së cilës është bërë apelimi mund të parashtrroj përgjigje në apel PZAP-it. Përgjigja duhet të dorëzohet në PZAP brenda kohës së paraparë në njoftim.

12.2 Përgjigja në apel e parashtruar nga KQZ-ja duhet të jetë e nënshkruar nga kryesuesi i KQZ-së apo personi i autorizuar. Ndërsa përgjigja në apel nga palët tjera duhet të jetë e nënshkruar nga pala që parashtron përgjigje apo nga personi i autorizuar.

12.3 Përgjigja duhet të ketë:

- a. arsyen pse apelimi duhet të refuzohet.
- b. çdo dëshmi relevante që e përkrah atë vlerësim dhe
- c. verifikimin nga kryesuesi lidhur me vërtetësinë e përgjigjes.

12.4 Përgjigja në apel mund të dorëzohet në selinë e PZAP-it në Prishtinë drejtëpërdrejt apo përmes postës.

12.5 Mosdorëzimi i përgjigjes në kohë të duhur siç është paraparë në këto rregulla nuk është pengesë që PZAP-i të vazhdojë me shqyrtimin e apelit.

Neni 13 **Vendimet për apeline**

13.1 PZAP-i ofron bazat ligjore dhe faktike për vendimet e tij me shkrim. PZAP-i u ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim, palëve të përfshira, brenda afatit prej shtatëdhjetedy (72) orëve nga momenti i lëshimit të vendimit, në rast se ai ndikon në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Për vendimet tjera PZAP-i ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim palëve të përfshira në çështje, brenda pesë (5) ditëve kalendarike.

13.2 Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të apeleve, kryesuesi i panelit vendim marrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e apeleve që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, dhe se ato apele të trajtohen me një vendim.

13.3 Panelet vendim-marrëse mund ta refuzojnë apelimin apo një grumbull apelimesh, nëse nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore dhe me rregullat zgjedhore në fuqi, apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.

13.4 Paneli vendim marrës mund që me veteiniciativ kur e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme të fillojë hetimin lidhur me çështjet e apelit, por nuk është i obliguar ta bëjë këtë.

13.5 Sipas detyrës zyrtare, panelet vendim-marrëse mund të mbajnë seanca dëgjimore, të cilat do të mbahen në atë mënyrë që paneli e konsideron si të duhur. Paneli mund të mbajë seanca të mbyllura dëgjimore apo të mos përfshijnë në atë seancë ose në cilëndo pjesë të saj çdo person a grup personash, në rastet kur paneli mendon se për arsye të rendit publik ose të sigurisë së cilësdo prej palëve të përfshira mund të kërkohet marrja e vendimit të tillë.

13.6 Gjatë mbajtjes së seancës dëgjimore, paneli mund:

- a. të kërkojë nga çdo person që të vijë dhe t'i paraqesë dëshmitë që mund të ndihmojnë panelin në marrjen e vendimit.
- b. t'ua mundësojë dëshmitarëve të japin dëshmi nën betim apo në ndonjë mënyrë tjetër.
- c. të kërkojë dhe të pranojë dëshmi relevante, të cilat paneli i konsideron si të duhura.

13.7 Panelet vendim-marrëse do të shqyrtojnë të gjitha dëshmitë relevante të dorëzuara me kohë. Bazuar në këto dëshmi dhe në dëshmitë e tjera, të cilat paneli mund t'i merr në konsideratë, panelet vendim-marrëse e pranojnë apelimin në rastet kur pretendimet

janë mirë të bazuara. Panelet vendim-marrëse i refuzojnë apelimet që nuk e plotësojnë këtë standard. Përgjegjësia për dhënien e dëshmisë është në anën e palës që e bën apelimin. Panelet vendim-marrëse mund të shqyrtojnë sipas detyrës zyrtare dëshmi të tjera relevante, por nuk janë të obliguar ta bëjnë një gjë të tillë.

13.8 Paneli vendimmarrës nëse e aprovon si të bayuar apelin ai me vendim e urdhëron KQZ-në që ta rishqyrtojë vendimin e saj apo që të ndërmerr veprime korrigjuese.

13.9 Vendimet e PZAP-it lidhur me ankesat dhe apelet duhet të përpilohen me shkrim të përmbajnë dispozitiv të qarte dhe arsytim për gjendjen faktike të vërtetuar si dhe dispozitat përkatëse për aplikimin e të drejtës procedurale dhe materiale, të cilat vendime duhet të ju ju dërgohen palëve në afatet e përcaktuara në nenin 118.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-256),

13.10 Vendimet e PZAP-it do të publikohen në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, Ligji Nr. 02/L-37. Të gjitha vendimet do të jenë në dispozicion të publikut përmes web faqes së PZAP-it.

Neni 14

Procedura për Administrimin e Hetimeve të Materialit Zgjedhor

14.1 Kur PZAP-i pranon një ankesë që konsiderohet të jetë e rregulltë, dhe kur një ankesë e tillë është e dyshuar për veprimtari mashtruese që përfshin materialin zgjedhor, Paneli vendimmarrës do të autorizoj një anëtar të panelit, si hetues kryesor si dhe zyrtarin ligjor të ngarkuar në çështjen konkrete që ti zhvilloj hetimet.

14.2 Hetuesi kryesor do të jetë përgjegjës për të bërë kopjet e të gjitha materialeve përkatëse zgjedhore siç specifikohet në nenin 103.1 e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji nr 03/L-256), brenda lokacionit të cilën KQZ-ja e ka caktuar, sipas nenit 103.3 të LQP-së.

14.3 Hetuesi kryesor mund të ndihmohet në aktivitetet e lartpërmendura nga anëtarë të tjerë të Sekretariatit të PZAP-it, me autorizim nga Kryesuesi i PZAP-it ose kryesuesi i panelit vendim-marrëse.

14.4 Hetuesi kryesor duhet të bëjë një Inventar (dosje të lëndës) të dëshmimeve, duke detajuar të gjitha materialet zgjedhore të kopjuara.

14.5 Pas shqyrtimit të materialit zgjedhor, Hetuesi kryesor duhet të bëjë një raport preliminar hetues, duke siguruar një analizë të hollësishme të materialit zgjedhor.

14.6 Raporti preliminar hetues, së bashku me inventarin (dosjen e lëndës) e dëshmimeve dhe materialin zgjedhor, do t'i paraqitet panelit për shqyrtim të mëtejshëm.

Neni 15
Dispozitat kalimtare

15.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it të datës 17 Nëntor 2010.

15.2 Pjesë përbërse e kësaj Rregulle është edhe :

Shtojca I - Formulari për ankesa dhe apele

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull hyn në fuqi me datë: 04. 12. 2015

Kryesuesja e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa



Nazmije Ibrahim

Nazmije Ibrahim